



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2022:102225  
Datë: 28.10.2024  
Numri i dokumentit: 06359889

**C.nr.287/2022**

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA VITI**, gjyqtari Arben Xheladini, me bashkëpunëtoren profesionale, Lumturije Fetahu Xhelili, në çështjen kontestimore të paditësit, P.A., nga Vitia Rr. “Shotë e Azem Galica” nr.6, të cilin e përfaqëson M.A., avokat në Viti, kundër paditurës, Kompania e Sigurimeve “Eurosig” sh.a., me seli në Prishtinë, Rr. “2 Korriku” nr.19, me objekt të kontestit kompensim i dëmit material dhe jo material, vlera e kontestit 2600 Euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor më datë 11.10.2024, jashtë seancës, mori këtë:

**AKTGJYKIM**

I. Miratohet kërkesëpadia e paditësit, P.A., detyrohet e paditura, Kompania e Sigurimeve “Eurosig”, që paditësit, për shkak të aksidentit të datës 21.02.2022, t’ia shpërblej dëmin në këtë mënyrë: për dhimbje fizike 1000 Euro, për frikë 1000 Euro dhe për ushqim të përforcuar 200 Euro, për kujdes nga personi tretë 300 euro, për shërim klimatik fizioterapik 100 euro, të gjitha në shumë 2600 Euro, me kamatë ligjore 8%, për dëmin jo material e llogaritur nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit, ndërsa, për dëmin material nga dita e dorëzimit të padisë në gjykatë, e deri në pagesën e plotë, në afat prej 15 ditëve nga pranimi i aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit.

II. Detyrohet paditësi që, në afat prej 15 ditëve nga pranimi i aktgjykimit, ta paguaj taksën gjyqësore për padi në shumë prej 40 Euro, nën kërcënim të përmbarimit.

III. Detyrohet e paditura që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 809 Euro, në afat prej 15 ditëve nga pranimi i aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit.

**Arsyetim**

Paditësi P.A., përmes përfaqësueses së tij ligjore- nënën Magbule Avdiu, më datë 20.05.2022, e ka filluar procedurën kontestimore kundër të paditurës, Kompania e Sigurimeve “Eurosig”, me arsyetimin se në aksidentin e komunikacionit të ndodhur më datë 21.02.2022, në magjistralen Viti-Kllokot, në hyrje të Vitisë përballë maketit “Viva Fresh”, ka pësuar lëndime trupore. Shkaktari i aksidentit, veturën e tij, **VË Touran**, me targa 05-757-FM, të cilën e drejtonte F.B.nga Vitia, e ka pasur të siguruar në Kompaninë e Sigurimeve “Eurosig” nga e cila para fillimit të procesit kontestimor, në procedurë jashtëgjyqësore e ka kërkuar shpërblimin e dëmit, por e paditura ia kishte refuzuar kërkesën. Pas administrimit të ekspertizave, e ka saktësuar kërkesën dhe ka kërkuar të detyrohet e paditura që paditësit, për dhimbje fizike të të gjitha llojeve t’ia paguaj shumën 1000 Euro, për frikë të të gjitha llojeve 1000 Euro, për ushqim të përforcuar 200 Euro, në emër të kujdesit nga personi i tret për tri javë shumën prej 300 euro dhe për rehabilitim në vende klimatike

100 Euro, të gjitha në shumë 2600 Euro, me kamatë ligjore 8 % nga dita e dorëzimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar të specifikuara: për përpilim të padisë 104 Euro, për përfaqësim në tri seanca secila nga 135 Euro, për dy ekspertiza mjekësore shumë e përgjithshme 300 Euro, shuma e përgjithshme 809 euro, duke u bazuar në Rregulloren për Tarifa të OAK-së.

E paditura, përmes përfaqësuesit të saj, e ka kundërshtuar bazën ligjore të padisë me arsyetimin se paditësi vizitën e parë në një institucion shëndetësor e ka bërë pas kalimit të afatit prej 24 orësh nga momenti i aksidentit. Kundërshtimin e ka bazuar në atë se aksidenti ka ndodhur më datën 21.02.2022, ndërsa i paditësi është paraqitur në QKMF më datën 23.02.2022, dhe për këtë arsye edhe kërkesa e paditësit në procedurën jashtëgjyqësore ishte refuzuar, për shkak se raporti mjekësor është jashtë afateve të parapara me rregulloren për përcaktimin e kritereve për vlerësimin e dëmeve jo materiale nga auto-përgjegjësia respektivisht neni 12.Pika 3, sipas të cilit raportet mjekësore duhet të jenë brenda 24 orëve. Ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj e pabazuar.

Propozimet për prova materiale nuk i ka kundërshtuar, ka pasur vërejtje në provat e administruara materiale, nuk e ka kundërshtuar ekspertizën e ekspertit psikiatër, ndërsa vërejtje ka pasur në ekspertizën e ekspertit ortoped, dhe ka kërkuar që ortopedi të dëgjohet në seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike gjykata i ka administruar raportin e policisë 2022-CR-140 datë 21.02.2022, Aktgjykimin K. nr. 91/2022, raportin mjekësor të QKMF në Viti nr. 1078/31 datë 22.02.2022, raportin mjekësor nga Ordinanca Specialistike Ortopedia e datës 26.02.2022, raportin mjekësor nga Spitali i Gjilanit nr. 481 datë 23.02.2022, udhëzim për konsultim nga QKMF e datës 03.03.2022, raportin mjekësor nga konsulta në Gjilan nr. 1098 të datës 03.03.2022, recetë e barnave 23.02.2022, raporti nga fizioterapeuti ambulanta për fizioterapi në emër të "Tretmani 2" me datë 12.04.2022, kuponi fiskal i datës 12.04.2022 në shumë prej 100 eurove, raportet mjekësore nr. 280 datë 03.10.2022, nr. 304 datë 17.10.2022 dhe 335 datë 07.11.2022, ekstraktin e lindjes për P.A.n, të datës 28.02.2022, ekspertizën R.H., ekspert psikiatër, dhe ekspertizën e A.L., ekspert ortoped-traumatolog.

Me leximin e raportit të policisë 2022-CR-140 datë 21.02.2022,

Aktgjykimin K. nr. 91/2022,

raportin mjekësor të QKMF në Viti nr. 1078/31 datë 22.02.2022,

raportin mjekësor nga Ordinanca Specialistike Ortopedia e datës 26.02.2022,

raportin mjekësor nga Spitali i Gjilanit nr. 481 datë 23.02.2022,

udhëzim për konsultim nga QKMF e datës 03.03.2022,

raportin mjekësor nga konsulta në Gjilan nr. 1098 të datës 03.03.2022,

recetë e barnave 23.02.2022,

raporti nga fizioterapeuti ambulanta për fizioterapi në emër të "Tretmani 2" me datë 12.04.2022,

....

kuponi fiskal i datës 12.04.2022 në shumë prej 100 eurove,

raportet mjekësore nr. 280 datë 03.10.2022, nr. 304 datë 17.10.2022 dhe 335 datë 07.11.2022,

ekstraktin e lindjes për P.A.n, të datës 28.02.2022

Me ekspertizën e eksperti ortoped, A.L., gjykata ka vërtetuar se paditësi P.A., në aksidentin e komunikacionit të datës 21.02.2022 ka pësuar ndrydhje në shputë dhe ënjtje të saj, ndrydhje e bërrylit të djathtë, e që kualifikohen si lëndime të lehta trupore. Se në çastin e lëndimit, paditësi ka pësuar dhimbje me intensitet të lartë 1 orë-të paraqitur kohë pas kohë deri në marrjen e terapisë; dhimbje fizike të intensitetit të mesëm 17 ditë – që janë paraqitur kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë adekuate, e që ndërliken me kohën e nevojshme për konsolidimin e lëndimeve, procedurat diagnostike dhe terapeutike, dhe me intensitet të ulët-21 ditë – që janë paraqitur kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë adekuate, e që ndërliken me kohën e nevojshme për konsolidimin e lëndimeve, procedurat diagnostike dhe terapeutike. Po ashtu, eksperti ka gjetur se paditësi ka pasur nevojë për ndihmë nga personi i tretë 21 ditë, dhe për ushqim të përforcuar 21 ditë-ushqim i pasuruar me vitamina dhe minerale për rritjen e imunitetit, dhe për rehabilitim fiziatrik 10 ditë pasi trajtimi ka qenë i nevojshëm për përmirësimin e lëvizjeve në nyjet e bërrylit dhe këmbës, në ekstremitete dhe rritjen e forcës dhe masës muskulore të dobësuar si pasojë e shtangimit në nyje për shkak të pamundësisë së lëvizjeve në kohën e shërimit dhe mbajtjen e mobilizimit.

Sipas kërkesës së përfaqësuesit të të paditurës, gjykata e ka thirrë ekspertin ortoped-traumatolog në seancën e shqyrtimit të datës 11.10.2024, e paditura ka munguar në këtë seancë e cila sipas propozimit të përfaqësuesit të paditësit, është mbajtur në mungesë të saj. Eksperti ka dhënë sqarime se të gjitha lëndimet e paditësit kanë qenë si pasojë e aksidentit të datës 21.02.2022 dhe kanë lifhje kauzale me këtë aksident.

Eksperti psikiatër, R.H., në pjesën e konstatimit të tij me shkrim ka gjetur se paditësi, në ditën kritike ka pësuar frikë primare që ka zgjatur disa sekonda-e shkaktuar nga aksidenti si frikë nga vdekja, dhe frikë sekondare që nënkupton ankthin, shqetësimin aktivitetin shtesë për shkak të dëmtimeve të pësuar, prishjen e klimës psiko-sociale, preokupimin e kontroleve mjekësore, frikën rreth pasojave eventuale. Sipas ekspertit, frika sekondare ka qenë e intensitetit të lartë dhe ka zgjatur 30 minuta, pastaj me intensitet të mesëm 24 orë dhe me intensitet të ulët 6 javë.

Pasi gjykata i ka administruar të gjitha provat materiale, në bazë të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), i ka çmuar një nga një dhe të gjitha së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, andaj, edhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me administrimin e ekspertizës së ortopedit-traumatolog, gjykata ka vërtetuar natyrën e lëndimeve dhe pasojat nga lëndimi, kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike dhe nevojën për ushqim të përforcuar. Gjikata ia fali besimin e plotë ekspertizës së ortopedit-traumatolog, pasi ishte profesionale dhe me të janë vërtetuar faktet kryesore të çështjes për kërkesat e paditësit që ndërliken më këtë ekspertizë.

Po ashtu, me ekspertizën e ekspertit psikiatër, gjykata ka vërtetuar se paditësi ka përjetuar frikë primare për disa minuta, dhe frikë sekondare me intensitet të lartë, të mesëm dhe të ulët, në kohëzgjatje si në këtë konstatim. Gjikata ia fali besimin e plotë ekspertizës, pasi ishte profesionale dhe me të janë vërtetuar faktet kryesore të çështjes për kërkesat e paditësit që ndërliken më këtë ekspertizë.

## Baza ligjore

Si ligj material e zbatohet Ligjin e Marrëdhënieve të Detyrimeve të vitit 2012, të cilit tani e tuje do t'i referohet me shkurtësën LMD, konkretisht: Nenin 137: “Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material”); Neni 169: “Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi. 2. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla. 3. Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t'ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit.”; Nenin 183.1 “Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material. 183.2: “Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror.”

Pasi gjykata e ka vërtetuar gjendjen faktike, ka vlerësuar se dhimbjet e përjetuara fizike, intensiteti dhe kohëzgjatja e arsyetojnë gjykimin e shpërblimit në të holla në shumë prej 1000 Euro, në mënyrë që paditësi t'i përballojë më lehtë pasojat e lëndimeve. Me rastin e përcaktimit për lartësinë e shumës në të holla, gjykata ka pasur parasysh të mirën e mbrojtur juridike, moshën e paditësit, natyrën e lëndimit dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve të përjetuara, por edhe faktin se dhimbjet nuk kanë qenë me intensitet posaçërisht të lartë. Duke qenë se lëndimet e paditësit kanë qenë ndrydhje e shputës dhe bërrylit të djathë, gjykata ka gjetur se përjetimet nga lëndimi dhe kohëzgjatja e dhimbjeve e arsyetojnë shumën e gjykuar përkundër që paditësi nuk ka përjetuar dhimbje me intensitet posaçërisht të lartë.

Kërkesën e paditësit për frikën e përjetuar, gjykata e miratoi në shumë prej 1000 Euro pasi me ekspertizë të ekspertit psikiatër u vërtetua se paditësi ka pësuar frikë primare e po ashtu edhe frikë sekondare. Me rastin e përcaktimit për lartësinë e shumës në të holla, gjykata ka pasur parasysh të mirën e mbrojtur juridike, kohëzgjatjen e frikës së përjetuar, moshën e paditësit, e po ashtu edhe faktin se e paditura nuk ka pasur vërejtje në ekspertizën psikiatrike.

Gjykata vlerëson se shumata e gjykuara janë adekuate në raport me rëndësinë e shkeljes së të mirës së mbrojtur, dëmet e pësuar, e gjithashtu edhe me kriteret dhe qëllimin e shpërblimit, për të arritur sadopak një satisfacion, edhe pse në parim, këto dy forma të dëmit vështirë se mund të kompensohen me para, dhe nuk kanë qëllime të përfitimit ashtu siç përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 183 të LMD-së.

Gjykata e ka aprovuar kërkesën e paditësit për ushqim të përforcuar, kujdes nga personi i tretë dhe shërim klimatik, duke u bazuar në ekspertizën e ekspertit ortoped, pasi në rastet e dëmtimit të shëndetit, paditësi ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar me vitamina dhe minerale të ndryshme, ndërsa, lartësia e gjykuar në shumë prej 200 Euro-për kujdes nga personi i tretë dhe 300 Euro-për ushqim të përforcuar u bazua në kohëzgjatjen e kësaj nevoje dhe kriteret sipas praktikës gjyqësore në këto raste. Ndërsa, shumata e miratuar prej 100 Euro për shërim fiziatrik u mbështet

me provë materiale – kuponi fiskal i datës 12.04.2022, për faktin se ekspertit ortoped ka vërtetuar se paditësi ka pasur nevojë për trajtim fiziatrik.

Pretendimet e të paditurës se paditësi vizitën e parë në institucion shëndetësor e ka pasur pas kalimit të afatit prej 24 orëve gjykata e vlerësoi të pabazuar pasi në Aktgjykimin K. nr. 91/2022, është vërtetuar lidhja kauzale e lëndimeve që paditësi i ka pësuar në aksidentin e datës 21.02.2022, ndërsa ekspertit ortoped i ka vërtetuar natyrën e lëndimit dhe pasojat nga lëndimi. Me këtë aktgjykim, gjykata e ka vërtetuar bazën ligjore të kërkesëpadisë së paditësit, meqë shkaktari i aksidentit në procedurë kundërvajtëse është gjetur fajtor për shkaktimin e aksidentit.

Gykata vë në dukje se çështja që e paditura e ka ngreh gjatë shqyrtimit do të mund të ishte me ndikim në bazën ligjore të kërkesës së paditësit, sikur paditësi të mos e dorëzonte aktgjykimin për të vërtetuar pretendimin se në ditën e aksidentit i ka pësuar lëndimet trupore në këmbë. Pikërisht, për shkak se e paditura mbi bazën e kontestimit të kërkesës për kompensim në procedurë jashtëgjyqësore, paditësi ka kërkuar mbrojtje gjyqësore, e të cilën gjykata e gjeti në tërësi të bazuar.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së, ashtu që e detyroi të paditurën që paditësit, t'ia paguaj shumat si në pikën I të dispozitivit me kamatë ligjore 8% në vit, për dëmin jo material e llogaritur nga data e nxjerrjes së aktgjykimit, ndërsa, për dëmin material nga dita e dorëzimit të padisë në gjykatë.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit duke u bazuar në dispozitat e Udhëzimit Administrativ NR. 01/ 2017 për Unifikimin e taksave Gjyqësore, e detyroi paditësin që të paguaj shumën prej 40 Euro në emër të taksës gjyqësore sepse, në shkresat e lëndë, nuk është dëshmia e pagesës së taksës.

Për shpenzime të procedurës, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit duke u bazuar në nenin 452, 453 dhe 463 të LPK-së, shpenzimet e miratuara kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjykatë dhe u kërkuan të specifikuar. Për këtë arsye, e paditura u detyrua që paditësit, t'ia paguaj këto shpenzime të procedurës: 104 Euro për përpilim të padisë, për tri seanca të mbajtura secila nga 135 Euro (sipas Rregullores për Tarifa të OAK-së bazuar në vlerën e kontestit nr. tarifor 6 dhe 7), për dy ekspertiza mjekësore secila nga 150 Euro (aq sa paditësi i ka paguar ekspertët), të gjitha në shumë prej 809 Euro.

Nga të lartcekurat e duke u bazuar edhe në nenin 142 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

## **GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA VITI**

**C.nr.287/2022, datë 17.10.2024**

**Gjyqtari,**

Arben Xheladini

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa, në kopje të mjaftueshme, dorëzohet përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2022:102225  
Datë: 28.10.2024  
Numri i dokumentit: 06359889